



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 136

Tiranë – E premte, 23 qershor 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10458, datë 15.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6825
Dekret i Presidentit nr. 10462, datë 19.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6825
Dekret i Presidentit nr. 10483, datë 19.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6825
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 23.6.2017	Për mbulimin e shpenzimeve të restaurimit të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, në varësi të Ministrisë së Kulturës, me qëllim akomodimin e organeve të Vetting-ut..... 6825

**DEKRET****Nr. 10458, datë 15.6.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Miguel Ari Lucas Verona Weber
2. Giovani Ibanor Morello Beltrame Pedotti
3. Idriz Naser Voca
4. Michael Alexander Moser
5. Milajete Fehmi Zhugolli (Potera)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bujar Nishani**

**DEKRET****Nr. 10462, datë 19.6.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 9, 14, 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Matina Arben Çukani
2. Violanda (Xhemile) Qamil Braka
3. Julian Çerçiz Manaj
4. Artan Zyhdi Kaiku
5. Telha Neshat Zoto

6. Artur Anastas Prifti
7. Melisa Muharrem Ceka
8. Anton Ndoc Prendi
9. Lindita Foto Mingo (Loli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bujar Nishani**

**DEKRET****Nr. 10483, datë 19.6.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fatos Haxhi Furra
2. Edmond Haxhi Furra
3. Valbone Agim Furra (Shipshani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bujar Nishani**

**VENDIM****Nr. 478, datë 23.6.2017**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË  
RESTAURIMIT TË ISH-GODINËS SË  
LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE  
ARTISTËVE, NË VARËSI TË  
MINISTRISË SË KULTURËS, ME  
QËLLIM AKOMODIMIN E ORGANEVE  
TË VETTING-UT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008,



“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Restaurimin, në vlerën 103 000 000 (njëqind e tre milionë) lekë, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, me qëllim sistemimin e ambienteve të saj aktuale në funksion të organeve të Vetting-ut.

2. Fondi i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, në masën 103 000 000 (njëqind e tre milionë) lekë, të përballohet nga fondet e buxhetit të vitit 2017, miratuar për Ministrinë e

Kulturës, zëri “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, në programin “Arti dhe Kultura”.

3. Këshilli i Ministrave, në rast të rishikimit të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, merr masa për kompensimin e vlerës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, Ministrisë së Kulturës.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë